Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 457/18, 461/18
Datë/Datum. 11.09.2018
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **AK: Agjencia Kadastrale e Kosovës** Grupi i OE ankues: **N.Sh."Geo-Map"&"Ave Consulting"shpk & "Sphaera"shpk&"Newa"shpk-Prishtinë** dhe **"Lorenco&Co"shpk & "Urban Metropol"shpk – Prishtinë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – OSHP: **Nr. 457/18** **Nr.461/18**
Prej:	**Sahit Beqiri** – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me **Nr. 452/18** & **Nr. 461/18** të parashtruar nga grupi i OE: **N.Sh. "Geo-Map"&"Ave Consulting"shpk & "Sphaera"shpk & "Newa"shpk - Prishtinë** dhe Grupi i OE: **"Lorenco&Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë.**		
Datë	**11.09.2018**		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën me datën: **31.08.2018** me **nr. 457/18** të parashtruar nga grupi i OE: **"Lorenco&Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë,** dhe lidhur me ankesen me datë: 03.09.2018 grupi i OE: **N.Sh."Geo-Map"&"AveConsulting"shpk&"Sphaera"shpk &"Newa"shpk – Prishtine,** dhe, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rindertimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti"** me nr. prokurimi: **60100-18-404-2-1-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – Agjencia Kadastrale e Kosovës.**
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *Grupin e OE ankues – N.Sh. "Geo-Map"&"Ave Consulting"shpk & "Sphaera"shpk & "Newa"shpk dhe Grupi i OE: "Lorenco&Co" shpk & "Urban Metropol" shpk*

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY
RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

	04.09.2018	**06.09.2018**	**11.09.2018**
Nënshkrimi i ekspertit	Data e autorizimit të ekspertit	Data e fillimit të ekspertizës	Data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: **31.08.2018** grupi i OE: **"Lorenco&Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë,** dhe lidhur me ankesen me datë: **03.09.2018** grupi i OE: **N.Sh."Geo-Map"&"AveConsulting"shpk&"Sphaera"shpk &"Newa"shpk – Prishtine,** kanë parashtruar ankesë në OSHP, **kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rindertimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti"**me nr.prokurimi:**60100-18-404-2-1-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Kadastrale e Kosovës.**

Ju njoftoj se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së më Nr.111/18, me datë 10.05.2018 si dhe OSHP lëshon Urdhëresë me Nr. 218/18, me datë 03.08.2018

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

N.111, LPP - Operatori Ekonomik Ankues:*"Lorenco&Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë*

Ne ankesen tone e bazojme ne këto nene LPP.
Neni 64 Deshmia e Kerkesave
Neni 65 Pranueshmeria e Kandidateve ose Tenderuseve
Neni 66 Pershtateshmeria Profesionale
Neni 69 Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Te nderuar qeshtja e eleminimit tone eshte arsyeja se topografet nuk jane gjeodet. Ne si kompani edhe ju si organe shqyrtues jeni te bindur se gjeodeti , topografi, markshajderi, geomatika, ingjinier i hartave, ingjinier gjeodezise dhe fotogrametris keta te gjithe jane gjeodet edhe paisen me licenca gjithashtu jane te regjistruar si gjeodet edhe ne odat e gjeodezise.

Kete e kemi deshmuar me keto fakte.

1. Leter nga shoqata e gjeodeteve te shqiperise.
2. Letra nga oda e Turkise.
3. Nga fletorja zyrtare e Republikes se Shqiperise (Ligji i Shqiperise).
4. Licenca te cilen e posedojne.

Kjo eshte e ditur ne tere boten se keto ndryshime te emrave te diplomave apo fakulteteve egzistojne, por keta jane te gjithe gjeodet dhe deshmojne me diploma te tyre. Ashtu qe ne nuk pajtohemi me kete vendim.

Ne vazhdim dote bashkangjisimim edhe disa nga rrethanat faktike rreth kesaj qeshtje.

Agjencioni Kadastral i Kosoves i eshte drejtuar me nje shkrese Shoqates se Gjeodeteve te Shqiperise dhe Universitetit Ploiteknik te Tiranes, ku edhe nga keta eshte konfirmuar ndryshimi i titujve te gjeodeteve nder vite por qe te gjithe keta kane bazament te njejte gjate studimeve dhe kryejn e te njejtat pune, gjithashtu kane dhene pergjigjie edhe per jo ngjashmerin mes Rindertimit te Informacioneve Kadastrale dhe Kontrate sherbimi per Evidentimin Faktik ne Terren te Ndertimeve pa leje Qarku Durres, d.m.th. keta kane mohuar qe keto dyja kan ngjashmeri mes vete.

a) Leter nga Uninoni i Odave Turke te Inxhinereve dhe Arkiteve;
b) Agim Kopani- Ing. Topograf dhe i licencuar si gjeodet;
c) Lorenc Zani – Ing. Gjeodet dhe i licencuar si gjeodet;
d) Ruzhdi Shehu – Ing. Topograf dhe i licencuar si gjeodet;

Dokumentet me siper [a, b, c, dhe d] ne pamundesi per ti vendosur ketu tek deklarate per shkaqe teknike do te bashkangjes me këtë raport si **KOPJE**, ashti siç ekziston ne ankesën e OE ankues.

Pretendimet ankimore nuk janë të njëjta me kërkesën për rishqyrtim pran AK – Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit.

Pasi tek kerkesa per rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues, OE ankues tek (hapesiara) Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues është e zbrazet (bosh).

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne ankesen tone e bazojme ne keto nene ne LRPP
Neni 64 Deshmia e kerkesave
Neni 65 Pranueshmeria e Kandidateve ose Tenderuesve
Neni 66 Pershtatshmeria Profesionale
Neni 69 Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar qeshtja e eliminimit tone eshte arsyeja se topografet nuk jane gjeodet. Ne si kompani edhe ju si organ shqyrtues jeni te bindur se gjeodeti,topografi, markshajderi, geomatika,ingjinjer i hartave, ingjijer gjeodezis dhe fotogrametris keta te gjithe jane gjeodet edhe paisen me licenca gjithashtu jane te regjistruar si gjeodet edhe ne odat e gjeodezise.
Kete e kemi deshmuar me keto fakte.

1. Leter nga shoqata e gjeodeteve te Shqiperise
2. Leter nga oda e Turkise
3. Nga fletorja zyrtare e Republikes se Shqiperise (Ligji i Shqiperise).
4. Licenca te cilen e posedojne.

Kjo eshe e ditur ne tere boten se keto ndryshime te emrave te diplomave apo fakulteteve egzistojne, por keta jane te gjithe gjeodet dhe deshmojne me diploma te tyre. Ashtu qe ne nuk pajtohemi me ket vendim.
Ne vazhdim do te bashkangjesim edhe disa nga rrethanat faktike rreth kesaj qeshtje.

Agjencioni Kadastral i Kosoves i eshte drejtuar me nje shkrese Shoqates se Gjeodeteve te Shqiperise dhe Universitetit Politeknik te Tiranes, ku edhe nga keta eshte konfirmuar ndryshimi i titujve te gjeodeteve nder vite por qe te gjithe keta kane bazament te njejte gjate studimeve dhe kryejne te njejtat pune, gjithashtu kane dhene pergjigje edhe per jo ngjashmerine mes Rindertimit te Informacioneve Kadastrale dhe Kontrate sherbimi per Evidentimin Faktik ne Terren te Ndertimeve pa leje Qarku Durres, dmth keta kane mohuar qe keto te dyja kane ngjashmeri mes vete.

Leter nga Unioni i Odave Turke te Inxhiniereve dhe Arkitekteve

UNIONI I ODAVE TURKE TË INXHINIERËVE DHE ARKITEKTËVE
ODA E INXHINIERËVE TË HARTAVE DHE INXHINIERËVE TË KADASTRIT (GJEODETËVE)
Rr: Şümer 1. Num:12/4, 06440 Yenişehiri/ANKARA Tel:(0312)232 5777 Fax: (0312) 230 85 74
Web:http://www.hkmo.org.tr e-mail: hkmo@hkmo.org.tr

Nr:2/A-1068 13/06/2018
Çeshtja: Informim

I nderuari **ERHAN YUSUF,**

Lidhur me email-in të datës **23.05.2018,**

Ju keni bërë pyetjen tek ne, për të informuar institucionin në Kosovë në të cilin keni marrë pjesë në tender, lidhur me dallimin në mes titullit të Inxhinierit të Hartave, inxhinierit të Gjeodezisë dhe Fotogrametrisë dhe Inxhinierit të Gjeomatikës, gjithashtu edhe për punët të cilat mund të jenë të ngjashme me punët e ***Rindertimit te Informacioneve Kadastrale*** si dhe a ka ngjashmëri ***Rindertimi I Informacioneve Kadastrale*** me punët për ***Matjen e Objekteve dhe Legalizimin e tyre.***

Në shtetin tonë ligjerimi në drejtimin e **Hartave dhe Kadastrit** ka filluar në vitin 1949 ne shkollen teknike në Stanboll, me emrin **Inxhinieri i Hartave**, pastaj në të ardhmen në këtë drejtim janë bapur disa degë ku kan| vazhduar ligjerimet në këtë drejtim. Sot numri i universiteteve në të cilat ligjerohet në këtë lëmi ka arritur 21, por emërtimi i degëve ndryshon.

Me kërkesë të fakulteteve Këshilli per Arsimim të lartë, (YOK) me datën 06.05.2009 ka lejuar që të bëhet emërimi i degëve në menyrë të lirë. Për këtë arsye në disa universitete është bërë emërtimi si ***Inxhinier te Hartave dhe kadastrit,*** një pjesë e tyre ka ndryshuar në ***Inxhinier te Hartave***, një pjesë tjetër ***ne Inxhinier te Gjeodezisë*** dhe ***Kadastrit*** ndërsa pjesa tjetër në ***Inxhinier te Gjeomatikës.***

Të gjithë këta si ***Inxhinieri i Hartave si Inxhinieri I Gjeodezisë dhe Fotogrametrisë*** gjithashtu ***edhe Inxhinieri I Gjeomatikës*** bazamentin e ligjëratave e kanë të njëjtë, pra janë nën ambrellen e ***Inxhinier te Hartave*** dhe ***Kadastrit***, të cilat janë të antarsuar në Odën tonë si persona të cilët kryejnë punëtë njëjta në këtë drejtim, kështu që të gjithë këta inxhinier I kanë të njëjtat të drejta dhe pergjegjësi vetëm se titujt e tyre janë të ndryshëm.

Në shtetin tonë, ***Rindertimi i Informacioneve Kadastrale*** është duke u tenderuar përmes Drejtoratit të përgjithshëm të Pronës dhe Katastrës. Për informimin e tuaj ne po ju dërgojmë informaten të cilën e kemi dowlandu përmes platformes elektronike të institucionit te tenderëve.

Ju mund te informoheni lidhur me keto lloje të punëve dhe cilat janë punët e ngjashme. Mendimi jonë është që ***Matja e Objekteve dhe Legalizimi i tyre*** me punën e ***Rindertimit të Informacioneve Kadastrale*** është e pamundur për tu pranuar si punë e ngjashëm.

Ju informojm, me nderime.

Ali IPEK
Sekretar i përgjithshëm ibordit.
(Nenshkrimi dhe vula zyrtare)
SHTES: Drejtorati I Përgjithshëm i Pronës dhe Kadastrit, me Numrin e regjistrimit 2017/577082.

Vërtetoj se përkthimi i faqeve e kësaj libreze
është plotësisht të barabartë me origjinalin:

Duygu Arslan Keçi, përkthyese gjyqësor

Agim Kopani-Ing Topograf dhe i licencuar si gjeodet



TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Komisioni i Dhënies së Licensave Profesionale

LICENSE
TZ.0597

MBIEMRI	KOPANI
EMRI	AGIM
ATESIA	RIZA
DATELINDJA	17.03.1966, Puke
VENDBANIMI	TIRANE
DIPLLOMUAR, ME	1988
TITULLI	Shkolla e Larte e Bashkuar
	Dega Topografi
Regjistruar ne Regjistrin themeltar qe nga data	22.08.2006

NE ZBATIM

Kat. 15 a Punime topografike
b Punime topogjeodezike ne objekte ndërtimore
c Punime specive gjeodezike, meta mbi shëtitjen, qendërtimin, brenda
d Punime fotogrametrike - hartografike

NE PROJEKTIM

Kat. 8 a Bazamente gjeodezike per punime ne te gjithe shtetin
b Projektim fotogrametrik - hartografik - topografik

KRYETARI I KOMISIONIT
Stavri RISTANI

Titulli i viteve 1988 Topograf

Kjo licenc ju jepet vetem gjeodeteve

SHKOLLA E LARTË E BASHKUAR E OFICERËVE «ENVER HOXHA»

DIPLOMË

Lorenc Zani- Ing.Gjeodet dhe i licencuar si gjeodet



LICENCE
T.1012

MBIEMRI	ZANI
EMRI	LORENC
ATËSIA	MILTIADH
DATËLINDJA	18.10.1968, Gramsh
VENDBANIMI	TIRANË
DIPLLOMUAR, MË	1996
TITULLI	Ing.Gjeodet
Regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data :	06.12.2010

NË PROJEKTIM

Kat. 8 a Bazamente gjeodezike per punime ne te gjithe shtetin
b Projektim fotogrametrik - hartografik - topografik

KRYETARI I KOMISIONIT
Ymer SHLLAKU

Titulli i viteve 1996 Ing.Gjeodet

Kjo licence ju jepet vetem gjeodeteve

Diplomë

Ruzhdi Shehu -Ing Topograf dhe i licencuar si gjeodet

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

LICENCË
T.0452/1

MBIEMRI	SHEHI
EMRI	RUZHDI
ATËSIA	BEQIR
DATËLINDJA	05.04.1965, Durrës
VENDBANIMI	TIRANE
DIPLOMUAR, ME	1986
TITULLI	Topograf (Shkolla e Lartë e Bashkuar)
Regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data :	25.02.2016

NË PROJEKTIM
Kat. 8 a Matjemetin gjeodezike – Rilevime në të gjitha shkallët

KRYETARI I KOMISIONIT
GERTA LUBONJA

Titulli viteve 1986 Topograf
Kjo licence ju jepet vetem gjeodeteve

SHKOLLA E LARTË E BASHKUAR E OFICEREVE "ENVER HOXHA"

DIPLOME
Nr. 6039.
Shoku Ruzhdi Beqir Shehu
mbaroi studimet për një vit 1986
në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha".
Me vendim të komisionit shtetëror
Nr. 12 datë 26.7.1986
bëhet oficer për specialitetin
KOMISARI: KOMANDANTI
28.7.1986
Nr. i Regj. 297

Nga fletorja zyrtare e Republikes se Shqiperise (Ligji i Shqiperise)

Kategoria 6.b –Eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.

Kategoria 6.c- Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

Kategoria 6.ç- Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

Kategoria 6.d- Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

7. PROJEKTUES URA DHE VEPRA ARTI

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

Kategoria 7.a – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Gjeoteknik), Inxhnier Hidroteknik.

Kategoria 7.b – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional), në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Hidroteknik/ Gjeoteknik), dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi (përjashtuar profili Hidroteknik).

Kategoria 7.c –Individë me diplomë master shkencor (jo profesional), në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: Strukturist ose Infrastrukturë e Transportit, dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi (përjashtuar profili Hidroteknik/Gjeoteknik).

Kategoria 7.ç –Individë me diplomë master shkencor (jo profesional), në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit: Strukturist ose Infrastrukturë e Transportit dhe profilin konstruksion të Inxhinierit Mekanik, dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi (përjashtuar profili Hidroteknik/Gjeoteknik) dhe profilin konstruksion të Inxhinierit Mekanik.

Kategoria 7.d – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional), në profilet e Inxhinierit të Ndërtimit (përjashtuar profili Hidroteknik), dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi, përjashtuar profili Hidroteknik.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

Kategoria 7.a - Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

Kategoria 7.b –Eksperiencë profesionale mbi 10 vjet.

Kategoria 7.ç- Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

Kategoria 7.d - Eksperiencë profesionale mbi 15 vjet.

8. PROJEKTUES GJEODET

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

Kategoria 8.a – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf/ Inxhinier Markshajder/Inxhinier Gjeomatik.

Kategoria 8.b – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf/ Inxhinier Gjeomatik/individë të cilët, kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional në degën Topografi/Gjeodezi ose pas një programi arsimor, zotërojnë titullin "Teknik Topograf".

Kategoria 8.c – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Gjeomatik/ Inxhinier Gjeoinformatik.

Kategoria 8.ç – Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf.

Kategoria 8.d – Individë me diplomë master shkencor (jo profesional) ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

Kategoria 8.a– eksperiencë profesionale mbi 3 vjet.

Kategoria 8.b– 1) Për Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf/ Inxhinier Gjeomatik/eksperiencë profesionale mbi 3 vjet. 2) Për individë me arsim të mesëm profesional të specialitetit topograf, eksperiencë profesionale mbi 15 vjet nga përfundimi i arsimit të mesëm apo nga momenti i marrjes së titullit "teknik topograf".

Kategoria 8.c- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

Kategoria 8.ç- Eksperiencë profesionale mbi 5 vjet.

N.111, LPP - Operatori Ekonomik Ankues: "N.Sh."GeoMap"&"AveConsulting"shpk & "Sphaera"shpk &"Newa"shpk – Prishtine.

Konsorciumi *"Geo – Map & Ave Consulting Shpk & Sphaera Shpk & News Shpk"* pas analizimit dhe studimit te dokumenteve relevante te Autoritetit Kontraktues dhe pas Vendimit te saj kundër Kërkesës për Rishqyrtim ne procedurën e prokurimit për: Ri-ndërtimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale, Komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti, konsideroj se Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka bere shkelje te dispozitave ligjore te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosovës.
Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosovës, janë mese vijon:

- *Është shkelur neni 65 – 68, i Ligjit te prokurimit Publik*
- *Është shkelur neni 69, i Ligjit te prokurimit Publik*
- *Është shkelur neni 7 dhe neni 13.4, i Ligjit te prokurimit Publik*
- *Është shkelur neni 59, i Ligjit te prokurimit Publik*
- *Është shkelur neni 72, i Ligjit te prokurimit Publik*
-

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Shkrimi nga OE ankues lidhur me deklaratën detale mbi fakte dhe argumente (për shkak se ka disa faqe dhe merr kohë për të shkruar, andaj për te mos e vonuar raportin/ekspertizën) do te bashkëngjisë me këtë raport si **KOPJE** ashtu si ekziston ne ankesën e OE ankues.

S-B

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Konsorciumi *Konsorciumi 'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'*, pas analizimit te teresishem te dokumenteve relevante te Tenderit per: **Ri-ndertimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale, Komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenice dhe Viti**, konstaton dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosoves, ka bere shkelje esenciale dhe substanciale te dispozitave ligjore te kornizes ligjore per prokurim publik ne mos shqyrtimin e Kerkeses per Ri-shqyrtim ne menyre te drejte, objektive dhe ligjore.

Pretendimet tona ankimore te drejtuara per shqyrtim tek Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit jane te njejta si me pretendimet ankimore te drejtuara Autoritetit Kontraktues nepermjet Kerkeses per Ri-shqyrtim dhe te ofruara me sqarime dhe argumente ligjore konkrete ne shkeljen e dispozitave ligjore nga Autoriteti Kontraktues.

Pikat e Ankeses per shkeljet e pretenduara te Autoritetit Kontraktues *jane te prezentuara si me vijon*:

1. Autoriteti Kontraktues, me daten 15/ 08 / 2018, nepermjet portalit E-prokurimi te KRPP-se, publikon Njoftimin per Anulim te Kontrates e prokurimin e Ri-ndertimit te informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale, Komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenice dhe Viti (**shih fakt nr. 1 – Njoftimi per Anulim te Kontrates Publike, i publikuar ne portalin E-prokurimi, me daten 15 / 08 / 2018**);

2. Konsorciumi *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'*, pas publikimit te Njoftimit per Anulim te Kontrates ka pergaditur dhe dorezuar Kerkesen per Ri-shqyrtim ne Autoritetin Kontraktues.

   Ne Kerkesen per Ri-shqyrtim kemi listuar argumente te mjaftueshme ligjore qe jane te pa-bazuara ligjerisht arsyetimet e ofruara per te eliminuar Oferten e Konsorciumit tone dhe kemi ri-potencuar se O.E 2 here i shpallur fitues 'Lorenco & Co & Urban Metropol' nuk i permbush kushtet themelore te Autoritetit Kontraktues te potencuara ne Dosje te Tenderit. (**shih fakt nr. 2 – Kerkesa per Rishqyrtim, e dates 17 / 08 / 2018**);

3. Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosoves, me daten 23 /08 / 2018, refuzon Kerkesen per Ri-shqyrtim duke potencuar se Referenca e Menaxherit te Projektit i ofruar nga Konsorciumi yne eshte i paligjshem dhe ri-mbesin prane konstatimeve te tyre se Oferta e Konsorciumit i udhehequr nga 'Geo – Map' eshte Oferte e pa-pergjegjshme me arsyetimet e njejta edhe ne dy vendimet paraprake te ketij Autoriteti.

   Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues te cekur ne Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Ri-shqyrtim jane te pa-bazuara ligjerisht dhe nuk kane mbeshtetje ligjore ne dispozitat ligjore te Ligjit te Prokurimit Publike dhe ligjeve tjera ne fuqi por nje akt i pa-shembullte i mos vleresimit te drejte dhe ligjore te Ofertes sone sipas nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik, e qe Oferta e Konsorciumit tona i ka permbushur te gjitha kushtet, kriteret dhe kerkesat e Autoritetit Kontraktues (**shih fakt nr.3 – Refuzimi i Kerkeses per Ri-shqyrtim, e dates 23 /08 / 2018**);

4. Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosoves, ne Raportin e vleresimit te Ofertave si dhe ne Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Ri-shqyrtim cek nje argument te pa-baze dhe te pa-ligjshem per te cilen ne dy vendimet paraprake nuk ka potencuar duke cekur se Menaxheri i Projektit, Zt. Fisnik Loshi nuk e ka referencen valide sepse nuk eshte e nenshkruar dhe se te njejten Reference e mohon Kompania turke.

   Ky konstatim i pa-baze, tendencioz dhe i pa-ligjshem i Autoritetit Kontraktues eshte ne kundershtim me kerkesen e percaktuar per Referenca ne Dosje te Tenderit ngase ne keto Kerkesa nuk 'specifikohet' se Referenca duhet te jete e nenshkruar por vetem te jete i leshuar nga Punedhensi.

   E kundershtojme arsyetimin per kete ceshtje te Autoritetit Kontraktues si te paligjshem sepse cdo punedhenes ne kohen dhe epoken digjitale mund te leshoje Reference nepermjet e-mailit per stafin e angazhuar ne Projekt dhe nje leshim i tille i References eshte valid dhe ligjor ngase eshte leshuar nga vete perfaqesuesi i Kompanise turke 'Emi Harita'.

   Eshte me rendesi te potencojme per anetaret e Panelit Shqyrtues dhe Ekspertin Shqyrtues qe perfaqesuesi ligjor (agjent i regjistruar) i O.E te shpallur fitues 'Urban Metropol' **eshte Zt.**

Erhan Yusuf, e qe i njejti ka punuar si Drejtor per Ballkan dhe perfaqesues i Kompanise turke 'Emi Harita'.

Prandaj, eshte e pa-ligjshme cdo tentim dhe arsyetim i Autoritetit Kontraktues per ceshtjen kontestuese per Referencen e leshuar per Zt. Loshi dhe Kompanise dy here te shpallur fituese 'Urban Metropol' sepse Kompania 'Urban Metropol' eshte konkurrent i drejteperdrejte i Konsorciumit *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'.*

Me pranimin e References te Zt. Fisnik Loshi si valide dhe ligjore nga Kompania 'Urban Metropol' dhe nga Kompania simoter turke 'Emi Harita' atehere fitues i kesaj kontrate publike shpallet Konsorciumi yne. Kjo eshte edhe **'arsyea kryesore' se pse Kompania 'Emi Harita' refuzon dhe e mohon Referencen e leshuar nga vet perfaqesuesi i kesaj Kompania turke**.

Keto veprime dhe akte te paligjshme te Kompanise turke 'Emi Harita' jane elemente te vepres penale per arsye se kjo Kompani turke ka fituar tenderin dhe ka nenshkruar kontraten publike me Agjencine Kadastrale te Kosoves per projektin e ri-ndertimit te informacionit kadastral ne Prizren dhe ne Kosove me Oferte duke ofruar CV-te dhe personelin turk nga Turqia mirepo projekti eshte implementuar ne Kosove me staf vendor te udhehequr nga Zt. Fisnik Loshi, qe tash per motive te ulta jo-profesionale e mohojne angazhimin e tij profesional ne projektin e Prizrenit si Kompania turke 'Emi Harita' dhe Agjencia Kadastrale e Kosoves.

Te gjitha keto veprime jane ne kundershtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe me ligjet tjera ne fuqi ngase nuk kane mbeshtetje ligjore sepse me keto veprime po tentohet me cdo kusht nga Agjencia Kadastrale e Kosoves qe te eliminojne nga gara Konsorciumin tone dhe te na mohojne fitimin e nje kontrate publike ne menyre te ligjshme dhe ne menyre te drejte.

5. Ne nderlidhshmeri, me piken 4, te kesaj Ankese, Konsorciumi *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'*, ri-potencon faktin se Zt.Loshi ka qene i punesuar nga **Kompania turke 'Emi Harita' qe ka pasur kontrate publike me Agjencine Kadastrale te Kosove**s per projektin: e Ri-ndertimit te informacionit kadastral (RIK) dhe qe Zt.Loshi, si Menaxher i Projektit ka punuar me shume se 14 muaj ne poziten e lartepermendur.

   Zt.Loshi, si Menaxher i Projektit gjegjesisht Udheheqes Ekipi per Ri-ndertim te informacionit kadastral ne Komunen e Prizrenit (Z.K Prizren dhe Z.K Vlashnje), ka punuar ne bashkepunim te plote me zyrtaret e Agjencise Kadastrale te Kosoves deri ne periudhen e implementimit te projektit dhe per punen e realizuar dhe te implementuar eshte paguar si Menaxher i Projektit nga Kompania turke 'Emi Harita'.

   E tere puna e implementuar nga Zt. Fisnik Loshi per angazhimin e tij argumentohet nepermjet konfirmimit te bankes komerciale per pagesat e bera nga 'Urban Metropol', Raportet e punes, procesverbalet e takimit dhe si dhe fotot e ndryshme te shkrepura gjate implementimit te projektit.

   Si pjese te pervojes per Zt.Loshi ofrojme nje Deklate e cila eshte e bashkengjitur ne Dosje ku argumentohet puna specifike ne Ri-ndertim te informacioneve kadastrale.

   Gjitheashtu, per punen shembullore dhe profesionale ne udheheqjen e projektit si Udheheqes Ekipi nga Zt. Loshi, eshte leshuar Referenca nga perfaqesuesi i Kompanise turke Zt. Erhan Yusuf nepermjet e-mailit ne formatin e zakonshem qe kjo firme turke leshon per personelin e saj te angazhuar ne projekte dhe nje Reference e tille eshte valide dhe ligjore (**shih fakt nr. 4 – Kopja e References per Zt. Loshi leshuar nga Kompania turke 'Emi Harita', Kopja e Raportit te Ri-vleresimit te fundit, Deklarata e Zt.Loshi, Konfirmimi nga Banka komerciale per Zt.Loshi, Raportet e Punes, Procesverbalet e takimit dhe fotot e shkrepura gjate implementimit te projektit kadastral ne Prizren**);

6. Konsorciumi *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'*, i konsideron plotesisht ligjore dhe te drejta 2 Raportet e Ekspertit Shqyrtues por edhe 2 vendimet e OSHP-se te dates 10 / 05 / 2018 dhe Urdheresen e dates 03 / 08 / 2018 duke e derguar lenden ne Ri-vleresim te Ofertave.

   Ne kete drejtim, Konsorciumi, ri-potencon argumentin ligjor edhe njehere duke theksuar se nuk eshte e vertete se Zt. Fisnik Loshi nuk ka 2 vite pervoje pune per Ri-ndertim te

informacionit kadastral.

Konsorciumi *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'* ne Oferte ka propozuar Zt. Fisnik Loshi, si Menaxher Projekti per arsye se Zt.Loshi ka pervoje me shume se 10 vjet ne lemite specifike dhe ka me shume se 2 vjet pervoje ne ri-ndertim te informacionit kadastral.

Gjitheashtu, ne pajtim me Udhezimin Administrativ nr. 01 / 2013, eshte Gjeodet i licencuar nga vete Agjencia Kadastrale e Kosoves dhe ka perfunduar studimet Master per Land Management ne Universitetin KTH - ROYAL INSTITUTE OF TECHNOLOGY ne Suedi dhe ka marr titullin Master.

Ne kete kontekst, ju inforojme qe Zt. Loshi eshte duke i ndjekur studimet PHD nga viti 2014 ne University of West Hungary, Departament of Geoinformatics me teme hulumtimi: New Approaches in 3 D cadastre – Qasje te reja ne 3 D Kadaster. Si rrjedhoje, si mundet Autoriteti Kontraktue te sfidoje dhe kontestoje Diplomen Master ne Unversitetin Suedez per kurrikulen e studimeve te Zt. Loshi kur i njejti person vazhdon studimet PHD – Doktorature per Kadaster ?.

Sipas nenit 3 dhe nenit 7 te Udhezimit Administrativ nr.01 / 2013, nje Gjeodet i licencuar duhet te kete se paku 3 vjet pune ne fushen e Kadastrit per te u licencuar dhe Gjeodet e licencuar mund te kryejne sherbime profesionale te ri-ndertimit te informacionit kadastral.

Si rrjedhoje Zt. Loshi ka plotesuar te gjitha kushtet ligjore te percaktuara ne Udhezimin Administrativ nr.01 / 2013.

Perpjekjet dhe arsyetimet ne Raportin e Vleresimit te Ofertave per here te fundit si dhe arsyetimet e ofruara ne Refuzimin e Kerkeses per Ri-shqyrtim nga Autoriteti Kontraktues eshte jo-ligjor, jo-profesional dhe subjektiv ngase nese Autoriteti Kontraktues konsideron se kurrikula e Universitetit ne Suedi nuk eshte e lemise specifike dhe per kadaster/gjeodet atehere eshte dashur te kontaktojne dhe te verifikojne ne menyre direkte perfaqesuesit e Universitetit Suedez dhe te marrin nje konfirmim me shkrim nga ky Universitet ne ceshtjen e ngritura nga vete Agjencia Kadastrale e Kosoves lidhur me permbajten e kurrikules ku Zt. Loshi ka diplomuar dhe ka marre titullin Master ne Land Management – Menaxhim i Tokes.

Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosoves nuk e ka kontaktuar Universitetin KTH-(ROYAL INSTITUTE OF TECHNOLOGY) ne Suedi ku Zt. Loshi ka perfundimet studimet ne Master dhe nuk ka marre asnje pergjigje nga Universiteti Suedez.

I vetmi autoritet per te konfirmuar aspekti ligjor te permbatjes se kurrikules dhe Diplomes Master te Zt.Loshi ka vetem Universiteti Suedez qe ka mandatin per te pergaditur stundentet ne ciklin e studimeve Master dhe per leshuar Diplomat e tilla dhe Jo pohimet e pa-baza dhe boshe te Autoritetit Kontraktues.

Prandaj, cdo veretje te Agjencise Kadastrale te Kosoves lidhur me Referencen per punen e tij si Menaxher Projekti gjegjesisht Udheheqes Ekipi ne projektin per Ri-ndertim te informacionit kadastral (RIK) ne Prizren dhe per Diplomen Master e Zt. Loshi ne Suedi konsiderohen te pa-ligjshme qe ky Autoritet nuk e njeh si Gjeodet Zt. Loshi, edhe pse eshte i licencuar dhe i diplomuar per Gjeodezi ne Suedi dhe ne Universitetin e Prishtines.

Autoriteti Kontraktues, ne asnje rrethane ligjore dhe faktike, nuk mundet te i mohoje angazhimin, pervojen profesionale dhe specifike, punen dhe meritat akademike te Zt.Loshi.

Eshte me rendesi te potencojme se Zt. Fisnik Loshi, eshte asistent Profesor ne Universitetin E Prishtines me titullin Inxhinier i Gjeodezise **(shih fakt nr.5 – Kopja e Diplomes Master te Zt.Loshi, kopja e licences si Gjeodet i licencuar nga Agjencia Kadastrale e Kosoves, si dhe kontratat e punes te Zt.Loshi qe argumentojne pervojen 10 vjecare ne lemite specifike dhe kontrata akademike ne UP);**

7. Konsorciumi *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'* ne Oferte ka prezentuar kontraten publike te anetarit te konsorciumit 'Ave Consulting' sh.p.k nga Shqiperia per punet e njejta per ri-ndertim te informaconit kadastral, ashtu sic eshte kerkuar ne Dosje te

Tenderit.

Kjo kontrate publike e realizuar ne Durres ne menyre te pa-ligjshme eshte kontestuar nga Zt. Avni Ahmeti, kryesues i komisionit te vleresimit te ofertave ne Agjencine Kadastrale te Kosoves, duke i drejtuar institucionit jo-kompetent per te bere vleresim si Shoqates se Gjeodeteve ne Shqiperi dhe ish profesorit te tij Zt. Gjata ne Universitetin Politeknik te Tiranes.

Ne teresi e hudhim poshte konstatimet e Shoqates se Gjeodeteve te Shqiperise qe eshte nje OJQ dhe aty ipen konstatime te pa-baza dhe jo-kompetent dhe jo-profesionale lidhur me ngjashmerine e projektit te realizuar na 'Ave Consulting' ne Durres me termat e references per projektin e ri-ndertimit kadastral ne Kosove.

Gjitheashtu, ne teresi, e kontestojme edhe pergjigjen jo-valide dhe jo-ligjore, te mikut dhe ish profesorit te Zt.Gjata te dhene ish studentit te tij, Zt. Avni Ahmeti nga Agjencia Kadastrale te Kosoves.

Te dy keto 'mendime' te personave jo-kompetent dhe jo-ligjor te OJQ 'Shoqata e Gjeodeteve' ne Shqiperi jane te pa-bazuara dhe te pa-ligjshme sepse rrugen e drejte dhe ligjore qe eshte dashur te ndjek Agjencia Kadastrale e Kosoves eshte te verifikoje punen dhe ngjashmerine e saj me vete Ministrine e Drejtesise se Republikes se Shqiperise ku 'Ave Consulting' ka ofruar sherbimin e saj profesional (**shih fakt nr. 6 – Kerkesa e Zt. Ahmeti drejtuar Shoqates se Gjeodeteve ne Shqiperi dhe Zt.Gjata dhe pergjigjet e Shoqates se Gjeodeteve ne Shqiperi dhe pergjigja e Zt.Gjata**);

8. Ne nderlidhshmeri, me piken 7, te kesaj Ankese, Konsorciumi *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'*, ofron deshmine ligjore te leshuar nga Ministria e Drejtesise ne Republiken e Shqiperise qe kontrata publike qe 'Ave Consulting' ka me Agjencine e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit te Zonave/Ndertimeve Informale, e dates 07 / 03 / 2018, e qe kjo Agjencie eshte ne vartesi te Ministrise se Drejtesise se Projekti i realizuar ne Durres eshte ne ngjashmeri te plote me termat e references per projektin e Ri-ndertimit te informacionit kadastrale ne Kosove.

   Poashtu, dorezojme me Ankese, edhe mendimin profesional dhe ligjor te Shoqates se Gjeodeteve te Kosoves se projekti i realizuar nga anetari i Konsorciumit 'Ave Consulting' ne Durres – Shqiperi eshte i ngjashem me termat e references per projektin kadastral ne Kosove.

   Per fat te keq, Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosoves, ne asnje proces te vleresimit dhe ri-vleresimit te ofertave nuk e ka shfrytezuar nenin 72 te LPP-se per te kerkuar informacione dhe sqarime konkrete si nga Ministria e Drejtesise ne Shqiperi per ceshtjen kontestuese te kontrates publike te firmes 'Ave Consulting' per projektin e tyre ne Durres ose per ceshtjen e Diplomes Master te Zt. Loshi ne Suedi ose per ceshtjen e References ose per ndonje ceshtje tjeter por vetem kane marre vendime te njeaneshme dhe subjektive me qellim te eliminimit te Konsorciumit tona nga konkurrenca dhe mohimit te fitimit te nje kontrate publike ne menyre te rregullte dhe ligjore.

   Eshte me rendesi te potencojme dhe te ri-theksojme se nuk pajtohemi me konstatimin e Znj. Valbona Hashani dhe Agjencise Kadastrale te Kosoves qe Zt. Art Hoxha, ekspert teknik i Organit Shqyrtues qe Zt. Hoxha ka thene se 30 % e projektit te realizuar ne Durres – Shqiperi ka ngjashmeri me termat e references se projektit kadastral ne Kosove sepse kjo nuk eshte e vertete qe eshte konstatuar nga Eksperti Shqyrtues dhe kjo mund te vertetohet edhe nga deshmia e Raportit te Ekspertit Shqyrtues (**shih fakt nr. 7 – Letra e Ministrise se Drejtesise te Republikes se Shqiperise dhe Letra e Shoqates se Gjeodeteve te Kosove, si dhe ekstrakti i konstatimit perfundimtar te Raportit te Ekspertit Shqyrtues**);

9. Konsorciumi *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'*, edhe pse ka dorezuar faktet ne 2 Ankesat e mehershme ne OSHP perseri do te i ri-potencojme disa nga faktet kryesore edhe ne kete Ankese per te demonstruar argumentet ligjore te pa-mohueshme qe O.E 'Lorenco & Co & Urban Metropol' per 2 here rradhazi eshte shpallur fitues edhe pse nuk ka plotesuar kushtet, kriteret dhe kerkesat e Autoritetit Kontraktues.

   Gjitheashtu, edhe Eksperti Shqyrtues por edhe anetaret e Panelit Shqyrtues te Organit

Shqyrtues te Prokurimit ne dy vendimet e saj te dates 10 / 05 / 2018 dhe dates 03 / 08 / 2018, jane pajtuar me argumentet e prezentuara dhe kane konstatuar se O.E 'Lorenco & Co & Urban Metropol' kane Oferte te pa-pergjegjeshme dhe nuk kane plotesuar kushtet, kriteret dhe kerkesat e Autoritetit Kontraktues.

Ne kete drejtim, ri-potencojme, se O.E 'Lorenco & Co & Urban Metropol' nuk ka plotesuar kerkesen e Autoritetit Kontraktues te specifikuar ne Dosje te Tenderit sepse ne Oferte ky O.E ka dorezuar personel qe kane Diplomen me titull OFFICER TOPGRAF dhe jo GJEODET nga Republika e Shqiperise dhe si personel me CV-te e tyre nga Republika e Turqise qe nuk jane Gjeodet te licencuar ne Republiken e Kosoves dhe qe nuk kane qene prezent fizikisht ne Kosove per projektet e listuar nga ky staf implementues.

Ne kete drejtim, kemi kontestuar Diplomat te Zt.Agim Kopani dhe Zt.Ruzhdi Shehu nga Republika e Shqiperise ngase jane leshuar nga Institucioni Arsimor Ushtarak te kohes se Enver Hoxhes dhe si te tille personat e lartepermendur nuk mund te konsiderohen Gjeodet por jane Oficer Topograf dhe plus nuk jane te licencuar ne Kosove per te ushtruar veprimtarine e Gjeodetit.

Gjitheashtu, te njejtat veretje sa i perket licencimit si Gjeodet kemi edhe per stafin implementues te Kompanise 'Urban Metropol' qe ka prezentuar staf nga Republika e Turqise qe nuk jane te licencuar per te ushtruar veprimtarine e Gjeodetit ne Kosove dhe plus keta persona qe jane propozuar si staf implementues kane cekur ne CV-te e tyre qe kane implementuar projekte te ngjashme ne Kosove me Agjencine Kadastrale te Kosoves kur keta persona te stafit turk nga Turqia nuk kane qene fizikisht prezent gjate implementimit te projekteve ne Kosove.

Si rrjedhoje, i tere personeli turk i O.E 'Urban Metropol' i propozuar per kete kontrate publike nuk i permbush kerkesat e Autoritetit Kontraktues dhe pervoja e tyre relevante nuk mund te pranohen si ligjore dhe valide duke perfshire edhe mungesen e licencimit te tyre si Gjeodet ne Kosove

Eshte me rendesi te potencojme se Udhezimi Administrativ nr. 01 / 2013, i parashtron kushtet ligjore per licencim te Gjeodeteve ne territorin e Kosoves me qellim te ushtrimit te profesionit te Gjeodetit. Asnje nga personeli i propozuar nga O.E 'Lorenco & Co & Urban Metropol' nga Republika e Shqiperise dhe Republika e Turqise nuk kane 'licence' te Gjeodetit te licencuar dhe si rrjedhoje nuk mund te ushtrojne kete aktivitet ne Kosove.

Duke u nisur se kushti themelor i licencimit te Gjeodeteve te licencuar per te ushtruar profesionin ne Kosove sipas Udhezimit Administrativ nr.01 / 2013 dhe per te perfunduar detyrat te percakuara ne termat e references ne kete prokurim te kontestuar nuk eshte permbushur atehere Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit duhet te konsideroje Oferten e Konsorciumit 'Lorenco & Co & Urban Metropol' si teresisht te pa-pergjegjshme dhe e njejta duhet te refuzohet nga Agjencia Kadastrale e Kosoves (**shih fakt nr. 8 - Kopja e Udhezimit Administrativ nr.01 / 2013, Kopja e Diplomave te stafit shqiptar nga Shqiperia per Zt. Agim Kopani dhe Zt.Ruzhdi Shehu, te propozuar nga O.E 'Lorenco' dhe Referencat stafit turk te propozuar nga O.E 'Urban Metropol'**);

10. Agjencia Kadastrale e Kosoves, ne menyre te paligjshme dhe subjektive por edhe dyshuese, ka leshuar dy Referenca me te dhena te ndryshme. Nje Reference ka leshuar enkas per 'Urban Metropol' te dates 28 / 02 / 2017, me nr. Protokoli 307 / 17 dhe Referencen tjeter te vecante per 'Lorenco & Co & Urban Metropol & Harita Insaat' te dates 07 / 04 / 2017 me nr. Protokoli 698 / 17 per te njejten aktivitet te prokurimit.

    Leshimi i pa-autorizuar i ketyre 2 referencave argumeton pohimin tone qe Agjencia Kadastrale e Kosoves eshte duke e favorizuar ne maksimum O.E 'Urban Metropol' dhe ne pamundesi qe te shpallin fitues kete O.E marrin vendim per te anuluar kontraten publike ne menyre qe Konsorciumi i udhehequr nga 'Geo – Map ' te mos shpallet fitues i tenderit per Ri-ndertimin e informacionit kadastral ne 15 zona kadastrale, Komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenice dhe Viti, qe i ka plotesuar te gjitha kushtet, kerkesat dhe kriteret e Dosjes se Tenderit (**shih fakt nr. 9 - 2 Referencat kontestuese per O.E 'Lorenco & Co & Urban Metropol**); dhe

11. Agjencia Kadastrale e Kosoves, ne menyre te pa-ligjshme ne kundershtim me nenin 13.4 te Ligjit te Prokurimit Publik i ka konsideruar valide dhe ligjore Diplomat dhe CV-te e stafit turk edhe pse ne legjislacionin primar dhe sekondar per prokurim publik specifikohet ligjerisht qe Oferta por edhe dokumentet permbajtesore si Diplomat, CV-te, kontratat, dhe cdo dokument tjeter duhet te dorezohen vetem ne 3 gjuhet zyrtare te Kosoves (shqip, serbisht dhe anglisht) dhe Jo ne gjuhet tjera te pa-autorizuara si gjuha turke qe nuk eshte gjuhe zyrtare ne Kosove per dorezim te dokumenteve gjate procesit te prokurimit per aktivitet e prokurimit qe menaxhohen nga Autoritetet publike te Kosoves.

Poashtu, Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosoves, ne kundershtim me nenin 32, paragrafi 2 te Udhezuesit Opertiv, e konsideron si valide dhe ligjore Formularin e Tenderit, edhe pse ky Formular nuk eshte plotesuar me emrin e personit te autorizuar per te nenshkruar ne emer te Konsorciumit duke perfshire edhe mungesen e DEKLARATE SE VECANTE te anetareve te Konsorciumit 'Lorenco & Co & Urban Metropol', ashtu sic kerkohet dhe sic parashihet me nenin 71, paragrafi 3 i Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves.

Autoriteti Kontraktues ne vend qe te refuzojne Oferen e Konsorciumit 'Lorenco & Co & Urban Metropol' si te pa-pergjegjshem ne aspektin administrativ dhe ligjor por e shpallin fitues per dy here rradhazi per tenderin kontestues.

Keto veprime te paligjshme te Autoritetit Kontraktues jane ne kundershtim me rregullat dhe procedurat e percaktuara ne Ligjin e Prokurimit Publik dhe vetem argumentojne pohimin tone ligjor se Autoriteti Kontraktues eshte duke e favorizuar ne maksimum O.E 'Lorenco & Co & Urban Metropol' dhe ne pamundesi qe kete O.E te shpallin fitues marrin vendim kunderligjor per anulim te kontrates publike ne menyre qe te mos shpallet fitues Konsorciumi *Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'.*

Me keto veprime te paligjshme, Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosoves, ka shkelur rende nenin 1 te Ligjit te Prokurimit Publik per arsye se Oferta financiare e Konsorciumit tone i udhehequr nga 'Geo – Map' eshte 56,000.00 Euro me e lire se O.E 'Lorenco & Co & Urban Metropol'.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsorciumi *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'* , me plotesimin e te gjitha kerkesave/kushteve te tenderit ka interes te caktuar materialo-juridik ne parashtrimin e Ankeses dhe ka qene Ofertuesi potencial per fitimin e kontrates publike poqese Autoriteti Kontraktues paligjshem te Anulonte procesin tenderues dhe mos te shpallte fitues dy here O.E 'Lorenco & Co & Urban Metropol', qe nuk i plotesojne kriteret, kushtet dhe kerkesat e potencuara ne Dosje te Tenderit.

Paneli shqyrtues i OSHP-se ka kompetence ligjore qe ndonje gabim teknik te Ofertes sone te konsideroje devijim te vogel teknik per arsye se Oferta e Konsorciumit *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'* eshte Oferte performuese dhe me cmim te lire qe ka plotesuar te gjitha kushtet, kerkesat dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues.

Prandaj, mos fitimi i nje kontrate publike ne menyre te rregullte ndikon ne shpenzime ligjore, humbje te fitimit nga projekti i realizuar, si dhe reputacioni i Kompanise sone ne tregun e Kosoves.

PROPOZIM

Duke u nisur nga prezentimi i argumenteve ligjore me arsyetim ligjor ne Ankese, Konsorciumi *'Geo – Map & Ave Consulting Sh.p.k & Sphaera sh.p.k & News sh.p.k'* kerkon nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit te beje shoshitjen e fakteve ne menyre ligjore duke marre **Vendim per te kthyer lenden e kontestuar perseri ne RI-VLERESIM te OFERTAVE,** ne menyre qe te detyrohet Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosoves, te beje vleresim te serishem te ofertave me anetar te rinj dhe te shpall fitues Konsorciumin tone qe ka plotesuar te gjitha kushtet, kerkesat dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues te potencuara ne Dosje te Tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	05.02.2018
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Kontratë 6 muaj - Shërbime
Vlera e parashikuar e kontratës:	300,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)	Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	23.02.2018
Data e hapjes së ofertave	23.02.2018
Data e përfundimit të Ri-vlerësimit të ofertave	15.08.2018
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e **eliminuar**	15.08.2018
Njoftimi për anulimin e aktivitetin e prokurimit	20.08.2018
Data e kërkesës për rishqyrtim	17.08.2018 & 20.08.2018
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim	23.08.2018

Kriteret për vlerësim:

III.2 KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesat e përshtatshmërisë:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kërkesat:	**Evidencat:**
1. Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. duke përdorur formën në Aneksin 2	1. Deklaratë nën betim -duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga O. Ekonomik
2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.	2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore (nga vendi prej na vjen kompania) - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës- origjinal/kopje
3. Vërtetimin nga Gjykata - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmërisë - te jete i lëshuar se paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit – origjinal/kopje e noterizuar.	3 Vërtetimin nga Gjykata kompetente - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës- origjinal/kopje e noterizuar

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Përshtatshmëria profesionale:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kërkesat:	**Evidencat:**
1. Certifikata e regjistrimit të biznesit (nga vendi prej na vjen kompania)	1. Kopja e Certifikatës se regjistrimit të biznesit(nga vendi prej na vjen kompania)
2. Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (nga vendi prej na vjen kompania)	2. Kopja e Certifikatës e TVSH-së (nga vendi prej na vjen kompania)
3. Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal (nga vendi prej na vjen kompania)	3. Kopja e Certifikatës me numër fiskal (nga vendi prej na vjen kompania)

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat:	**Evidencat:**
N/A	N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Kërkesat:	**Evidencat:**
Kualifikimet teknike dhe profesionale të kompanisë	Dëshmia e kërkuar dokumentare
1.Pjesëmarrja si kontraktor në së paku një (1) kontratë brenda tre (3) viteve të fundit (2015, 2016 dhe 2017) me vlerë të barabartë me çmimin/ofertën e ofertuar nga ofertuesi, që është përfunduar me sukses dhe detajisht dhe që ka të bëjë me punët e propozuara (Rindërtim të Kadastrit).	1.Listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare (2015,2016,2017), duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën, pranuesin si dhe një (1) Referencë apo raporte të pranimit të shërbimeve për realizimin me sukses, të barasvlershme me ofertën financiare të ofertuesit për këtë aktivitet të prokurimit.
2.Kualifikimet dhe eksperienca e stafit kyç Ofertuesi duhet të deshmoj se do të ketë personelin për pozicionet kryesore që plotësojnë kërkesat e mëposhtme:	

Nr.	Pozita	Përvojë pune të ngjashme në total (vite)	Përvojë pune të ngjashme (vite)
1	Menagjeri i projektit	10	8
2	Udhëheqësi i ekipit	5	3

2.1Menaxheri i projektit	2.1Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Një (1) Menagjeri i projektit me dhjetë (10) vite eksperiencë në punët e një natyre ekuivalente dhe vëllimit, së paku 2 vite pervoj pune në rindertimin e informaconeve kadastrale, duke përfshirë jo më pak se tetë (8) vite si udhëheqësi i ekipit dhe të ketë së paku nivelin e shkollimit Master ose inxhinier i diplomuar nga fusha e Gjeodezisë dhe Kadastrit.	Të dorëzohen: 1.CV-të e nënshkruara, 2.Kopja e diplomës e noterizuar, 3.Referencat mbi përvojen e punës.

S.B

2.2.Udhëheqësi i ekipit:

Pesë (5) Udhëheqësa të ekipit me pesë (5) vite eksperiencë në punët e një natyre ekuivalente dhe vëllimit, duke përfshirë jo më pak se tre (3) vite si mbikqyrës dhe të ketë së paku nivelin e shkollimit Bachelor nga fusha e Gjeodezisë dhe Kadastrit.

2.1Menaxheri i projektit

Një (1) Menagjeri i projektit me dhjetë (10) vite eksperiencë në punët e një natyre ekuivalente dhe vëllimit, së paku 2 vite pervoj pune në rindertimin e informaconeve kadastrale, duke përfshirë jo më pak se tetë (8) vite si udhëheqësi i ekipit dhe të ketë së paku nivelin e shkollimit Master ose inxhinier i diplomuar nga fusha e Gjeodezisë dhe Kadastrit.

2.2.Udhëheqësi i ekipit:

Pesë (5) Udhëheqësa të ekipit me pesë (5) vite eksperiencë në punët e një natyre ekuivalente dhe vëllimit, duke përfshirë jo më pak se tre (3) vite si mbikqyrës dhe të ketë së paku nivelin e shkollimit Bachelor nga fusha e Gjeodezisë dhe Kadastrit.

2.2.Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Të dorëzohen:

1.CV-të e nënshkruara,

2.Kopja e diplomës e noterizuar,

3.Referencat mbi përvojen e punës.

3.Pajisjet

Kompania duhet të dëshmoj se posedon pajisjet te listuara ne tabelen e meposhtme:

Nr.	Llojet e pajisjeve dhe karakteristikat	Numri minimum i kërkuar
1	GPS-GNSS rover	8
2	Stacion Total	5
3	Softuer për përpunimin e të dhënave	1
4	Kompjuter/llaptop	10
5	Mjete transporti	5
6	Fluturake pa pilot (dron)	1

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

3.1 Kompania duhet të ofrojë dëshmi mbi pronësinë, qiramarrjen apo kontratë për huazimin e pajisjeve.

Verejtje:

- Per cdo paqartesi rreth leximit te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, mund te ju referoheni Dosjes se Tenderit.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vlera e parashikuar	Vërejtje & E-prokurimi
1.	"Abkons" Shpk	Prishtinë	300,000.00 €	300,000.00 €	JO / Oferte ne letër
2.	Gr. i OE: "Lorenco & Co Shpk, - Dega ne Kosove, "Urban Metropol" Shpk	Prishtinë	294,046.90 €		JO / Oferte ne letër
3.	Gr. i OE: NSH "Geo-Map" ; & Ave Consulting Shpk; & Sphaera Shpk; & "News" Shpk	Prishtinë	238,000.00 €		JO / Oferte ne letër

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues:
Autoriteti Kontraktues për Ri-vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- **Esat Xani** – AKK, Kryetar i komisionit
- **Leonora Sylejmani** – AKK, Anëtar i komisionit
- **Reshat Murati** – AKK, Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni Ri-vlerësues ka konstatuar;
D E K L A R A T Ë:

Komisioni tek deklarata ne raport nuk ka shkruar arsyetim **(është e zbrazet)** por nga ky raport shihet se i kanë shpall te pa papërgjegjshëm t tre (3) OE pjesëmarrës në këtë AP dhe është nënshkruar nga komisioni vlerësimit me date 15.08.2018

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues

EMRI I OPERATORËVE EKONOMIK QË KANË DORËZUAR TENDER TE PËRGJEGJSHËM	VENDI	ÇMIMI € (Euro)
////	/////	////

- Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardhë në përfundim se **tri (3)** OE ofertues nuk janë të përgjegjshëm dhe kanë rekomanduar për anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit.

Menaxheri/ja i/e prokurimit aprovon/pajtohet me raportin e komisionit të vlerësimit.

S-B

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: "Lorenco&Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenet 64, 65, 66, dhe 69 te LPP-se.

Duke pas parasysh se OE ankuese konfirmo nenit 108/A te LPP-se, ka pasur mundësi dhe është dashur qe paraprakisht te gjitha pretendimet e veta ti parashtron pran AK, e qe ne rastin konkret OE ankuese këtë pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK me kërkesën për rishqyrtim, **eksperti shqyrtues** bazuar ne **nenin 109 te LPP-se** si dhe **paragrafit 9.2 te nenit 9** te dokumentit **F03 Rregullat për parashtrim te ankesave-verzioni 2**, ku thuhet: *"Ankesa do te dorëzohet ne origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues"* si dhe neni 13 par. 9 i Rregullores se OSHP-se Nr. 01/2017 ne te cilën thuhet: "*Ankesa duhet te jene te qarta, e shkurtër , dhe me pretendime e supozuara qe eventualisht janë shkelur nenet e caktuara te LPP-se nga ana e Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore parimisht duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues",* andaj nga te cekurat si me larte pretendimi ne fjale nuk është trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Gjithashtu, **eksperti shqyrtues sqaron**, sqaron se OE ankues nuk ka arritur te dëshmoj interes material nga rezultati i aktiviteti te prokurimit te zbatuar nga AK – AKK ne pajtim me nenin 4 par. 1.26 te LPP-se, po citoj: "***Palë e interesuar*** *- personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*", prandaj, bazuar ne **Vendimin OSHP-se Nr. 111/18** dhe **Urdhëresën e OSHP-se Nr. 218/18,** OE ankues nuk plotëson kërkesat ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe është pale pa interes ne këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: **"N.Sh."GeoMap"&"AveConsulting"shpk & "Sphaera"shpk &"Newa"shpk – Prishtine.**

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk respektuar nenin 7, 59, 65, 69, dhe 72 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se bazuar në **Rregulloren Nr. 01/2017** të Organit Shqyrtues të Prokurimit, **neni 16 (Rastet e unifikuara)** par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore te njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara **"res judikata"**, sipas nenit **105.2.16 te LPP-së**.

Gjithashtu, **eksperti shqyrtues sqaron** si ne vijim: Është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit/Ri-vleresimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve me kusht që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, duke marr parasysh Aneksin 1 në dosje të tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka respektuar **vendimin e OSHP-së me Nr. 111/18**, te datës 10.05.2018 dhe **Urdhëresën e OSHP-së Nr. 218/18,** të datës 03.08.2018, dhe duke mos vepruar ne pajtim, në tërësi me dispozitat ligjore të LPP-së.

S.B

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, rekomandojmë që ankesa e OE: **"Lorenco&Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë,** për tenderin e **AK – Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rindërtimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti"** me nr. prokurimi: **60100-18-404-2-1-1**, Refuzohet si të pabazuara (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet më lartë), ndera ankesa e OE: **N.Sh."Geo-Map"&"AveConsulting"shpk&"Sphaera"shpk &"Newa"shpk – Prishtine,** aprovohet si te bazuara (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë Autoritetin Kontraktues që ky aktivitet i prokurimit të **Ri-vlerësohet** duke respektuar **Urdhëresën e OSHP-se Nr. 218/18** e datës 03.08.2018 si dhe dispozitat ligjore në fuqi të LPP-së.